



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 6 dhjetor 2021
Nr. ref.:RK 1913/21

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI76/21

Parashtrues

Qemajl Babuni

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit
Ac. nr. 2023/2020, të 23 shkurtit 2021**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Qemajl Babuni, me vendbanim në Gjakovë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktvendimin [Ac.nr. 2023/2020] e Gjykatës së Apelit të 23 shkurtit 2021, në ndërlidhje me Aktvendimin [PPP.nr.302/2019] e Gjykatës Themelore në Gjakovë të 30 dhjetorit 2019.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të kontestuar, me të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e të drejtave të tij, të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 32 [E drejta për Mjete Efektive] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) dhe nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt gjyqësor] dhe neni 13 [E drejta për zgjidhje efektive] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNj).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 27 prill 2021, kërkesa u dorëzua në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 30 prill 2021, Kryetarja e Gjykatës, Arta Rama-Hajrizi, caktoi gjyqtarin Safet Hoxha gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Radomir Laban (anëtarë).
7. Më 17 maj 2021, bazuar në paragrafin 5 të nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës dhe rregullit 12 (Zgjedhja e Kryetarit dhe e Zëvendëskryetarit) të Rregullores së punës, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani u zgjodh Kryetare e Gjykatës Kushtetuese. Bazuar në paragrafin (4) të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP.71-2/21, u përcaktua që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani, detyrën e Kryetares së Gjykatës e merr pas përfundimit të mandatit të Kryetares aktuale të Gjykatës, Arta Rama-Hajrizi, më 26 qershor 2021.
8. Më 20 maj 2021, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe nga i njëjti kërkoi plotësimin e formularit të kërkesës dhe bashkëngjitjen e dokumentacionit mbështetës. Te njëjtën ditë një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës së Apelit.
9. Më 18 qershor 2021, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi në Gjykatë formularin e kërkesës të plotësuar, së bashku me dokumentacionin mbështetës.

10. Më 26 qershor 2021, bazuar në paragrafin (4) të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP.71-2/21, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani mori detyrën e Kryetares së Gjykatës, ndërsa bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, Kryetarja Arta Rama-Hajrizi përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtarës së Gjykatës Kushtetuese.
11. Më 10 nëntor 2021, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës që ta deklarojë kërkesën të papranueshme si qartazi të pabazuar.

Përmbledhja e fakteve

12. Kërkesa ka të bëjë me procedurë përmbarimore, ku parashtruesi i kërkesës paraqitet në cilësinë e debitorit, i cili sipas fakteve të rastit ka një detyrim ndaj kreditorit Raiffeisen Bank Kosova (RBKO), sipas marrëveshjes për kredi personale dhe marrëveshjes së pengut.
13. Më 17 tetor 2019, kreditori Raiffeisen Bank Kosova, kundër debitorit të parë M.B. (bashkëshortja e ndjerë) dhe parashtruesit të kërkesës, në cilësinë e debitorit të dytë, paraqiti propozim për përmbarim në bazë të dokumentit përmbarues, Marrëveshjes mbi kredinë personale [nr.120233721], Marrëveshjes mbi pengun [nr.120233721] dhe Marrëveshjes mbi fleksi-kredinë [nr.1202072278], për shumën e përgjithshme të detyrimit 7.433,26 euro.
14. Më 17 tetor 2019, përmbaruesi privat Gj.R., nëpërmjet urdhrit të përmbarimit [P.nr.972/2019], ka lejuar propozimin e kreditorit Raiffeisen Bank Kosova, duke vlerësuar se marrëveshja e pengut i plotëson kushtet e dokumentit përmbarues.
15. Më 22 tetor 2019, parashtruesi i kërkesës, ushtron prapësim në Gjykatën Themelore në Gjakovë, kundër urdhrit përmbarimor të 17 tetorit 2019, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale.
16. Më 23 tetor 2019, përgjigje në prapësim ka dorëzuar kreditori Raiffeisen Bank Kosova, nëpërmjet të cilin ka kërkuar refuzimin e prapësimit si të pabazuar.
17. Më 30 dhjetor 2019, Gjykata Themelore në Gjakovë, nëpërmjet Aktvendimit PPP.nr.302/19, e refuzoi si të pabazuar prapësimin e ushtruar nga parashtruesi i kërkesës, me arsyetimin se: *"Gjykata aktvendimin përkitazi me refuzimin në rastin konkret e ka mbështetur edhe në nenin 71 paragrafin 1 të LPP-së, lidhur me nenin 21 , 22 paragrafi 1.7 të LPP-së, ngase dokumenti në bazë të të cilit është lejuar përmbarimi është dokument përmbarimorë dhe ka tiparet e përmbarueshmërisë dhe gjeti se pretendimet e prapësimit nuk hyjnë në shkaqet tjera të nenit 71 të LPP-së, të cilat po qe se ekzistojnë mund të pengojnë përmbarimin e lejuar, andaj në kuptim të nenit 73.3 të LPP-së u vendos si në dispozitiv të këtij përmbarimi".*
18. Më 10 janar 2020, parashtruesi i kërkesës ushtroi të drejtën e ankesës në Gjykatën e Apelit, kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, të 30 dhjetorit 2019, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës përmbarimore,

vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale.

19. Më 23 shkurt 2021, Gjykata e Apelit, nëpërmjet Aktvendimit të kontestuar [Ac.nr. 2023/2020], refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe konfirmoi Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Gjakove të 30 dhjetorit 2019, si të drejtë dhe të bazuar në ligj, me arsyetimin: *"Gjykata e Apelit vlerëson se nuk qendron pretendimi ankimor i debitorit të dytë se aktvendimi i atakuar është marrë me shkelje të dispozitave të procedurës përmbarimore, për faktin se në rastin konkret përmbaruesi privat e ka lejuar përmbarimin duke u bazuar në Marreveshjen mbi Kredinë Personale me Nr.120233721, Marreveshjen mbi Pengun Nr.120233721, e cila është e regjistruar në regjistrin përkatës, dhe e njejta paraqet dokument përmbarues në kuptim të dispozitës së nenit 5 paragrafi 2 të Ligjit nr.05/L-118, për Ndryshimin dhe Plotësimin e LPP-së, shprehimisht përcaktohet se: "kontrata për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut", e që në rastin konkret janë përmbushur të gjitha kushtet e parapara ligjore për lejimin e përmbarimit. Nga kjo rezulton se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vepruar kur e ka refuzuar prapësimin e debitorit të parë ngase sipas Ligjit të Procedurës Përmbarimore përmbarimi lejohet në bazë të dokumentit përmbarimor e që në rastin konkret si dokument përmbarues është marrëveshja për pengun".*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

20. Parashtruesi i kërkesës pretendon se aktvendimet e kontestuar të gjykatave të rregullta kanë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], në lidhje me nenin 6.1 të KEDNj-së, nenin 32 [E Drejta për Mjete Efektive] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 13 [E drejta për zgjidhje efektive] të KEDNj-së.
21. Parashtruesi i kërkesës pretendon se aktvendimet e kontestuar janë tërësisht të pabazuara dhe kundërkushtetuese edhe për shkaqe procedurale juridike edhe për shkaqe materiale juridike, duke pretenduar se gjykata me aktvendimin PPP.nr.302/19 të 30 dhjetorit 2019 e ka caktuar atë si përfaqësues të përkohshëm, për debitorin e parë M.B., tani e ndjerë, pa vullnetin e tij dhe se e ndjera M.B., përveç tij ka lenë edhe trashëgimtarë të tjerë. Tutje, parashtruesi i kërkesës pretendon se lartësia e përcaktuar është e pa bazë dhe e papranueshme, sepse llogaritja e borxhit është bërë gabimisht, në dëm të tij, duke theksuar se këto janë shkaqe të mjaftueshme për prapësimin e përmbarimit. Për me tepër, parashtruesi i kërkesës pretendon se detyrimi është parashkruar, sepse kredia është marrë në vitin 2012, ndërsa propozimi për përmbarim është bërë në vitin 2019.
22. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata të mos i mundësohet kreditorit që të realizojë qëllimin e vet, në mënyrë kundërligjore, *"duke marrë të hollat tona në mënyrë të kundërligjshme,"* prandaj i propozoi Gjykatës të anulojë dhe t'i shpallë antikushtetuese aktvendimet e kontestuar gjyqësore.

Pranueshmëria e kërkesës

23. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të parashikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
24. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 4, të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

Neni 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara]

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

[...]

25. Gjykata në vazhdim shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen tutje në Ligj, përkatësisht me nenet 47, 48 dhe 49 të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47 [Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48 [Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49 [Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht...”

26. Përkitazi me përmbushjen e kriterëve të lartcekura, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës: i. legjitimohet si palë e autorizuar, në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës; ii. ai konteston kushtetutshmërinë e një akti të autoritetit publik, përkatësisht Aktvendimin Ac.nr. 2023/2020 e Gjykatës së Apelit, të 23

shkurtit 2021; iii. i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion, sipas nenit 113.7 të Kushtetutës dhe nenit 47.2 të Ligjit; iv. i ka specifikuar të drejtat e garantuara me Kushtetutë, të cilat pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit; dhe v. kërkesën e ka parashtruar brenda afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh, siç parasheh neni 49 i Ligjit.

27. Megjithatë, përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë], përkatësisht nënregullin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës, që përcakton:

(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.

28. Bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave, si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kategorizohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”; dhe në fund, (iv) pretendime “konfuze dhe të paqarta” (shih rastet e GjEDNj-së, *Kemmachev kundër Francës*, Aplikimi nr. 17621/91, kategoria (i), *Mentzen kundër Lituanisë*, Aplikimi nr. 71074/01, kategoria (ii) dhe *Trofimchuk kundër Ukrainës*, Aplikimi nr. 4241/03, kategoria (iii)).

29. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktvendimet e gjykatave të rregullta i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNj-së dhe nenin 32 të Kushtetutës në lidhje me nenin 13 të KEDNj-së. Andaj, në vlerësimin e këtyre pretendimeve, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GjEDNj-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë.

i. Sa i perket pretendimeve për shkelje të së drejtës për “gjykim të drejtë”

30. Gjykata në lidhje me këto pretendime i referohet dispozitave të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

“1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.”

[...]

31. Përveç kësaj, Gjykata rikujton gjithashtu përmbajtjen e nenit 6.1 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNj-së, që përcakton:

“1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë ... edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij.”

[...]

32. Gjykata vëren se parashtuesi i kërkesës pretendimin për shkelje të së drejtës së tij, për gjykim të drejtë e ndërlidh më me: 1) mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural, duke arsyetuar se urdhri përmbarimor nuk i përmbushte kushtet ligjore për tu pranuar si dokument përmbarues; dhe 2) parashkrimin e të drejtës për të kërkuar përmbushjen e detyrimit (kredisë).

a) Përkitazi me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale dhe procedurale

33. Gjykata vëren se parashtuesi i kërkesës pretendimin për shkelje të së drejtës së tij, për gjykim të drejtë e ka ndërtuar në baza ligjshmërie dhe jo në baza kushtetutshmërie, duke theksuar se gjykatat e rregullta në mënyrë të gabuar kanë aplikuar të drejtën procedurale dhe materiale në rastin e tij, kur vlerësuan se urdhri përmbarimor i përmbush kushtet ligjore për tu pranuar si dokument përmbarues.

34. Në kontekst të kësaj kategorie pretendimesh, Gjykata thekson se bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, e cila ndërlidhet me doktrinën e shkallës së katërt, vazhdimisht ka theksuar dallimin në mes të “kushtetutshmërisë” dhe “ligjshmërisë” dhe ka pohuar se nuk është detyrë e saj të merret me gabime të fakteve ose të interpretimit dhe aplikimit të gabuar të ligjit, që pretendohet se janë bërë nga gjykatat e rregullta, përveç dhe për aq sa gabimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë dhe me KEDNj (shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës KI179/18, parashtues *Belgjyzar Latifi*, Aktvendim për papranueshmëri i 23 korrikut 2020, paragrafi 68; KI49/19, parashtues *Shoqëria Aksionare Limak Kosovo International Airport S.H.A.*, “*Adem Jashari*”, Aktvendim i 31 tetorit 2019, paragrafi 47; KI56/17, me parashtuese *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 35; dhe KI154/17 dhe KI05/18, me parashtues, *Basri Deva*, *Afërdita Deva dhe Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar “Barbas”*, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 gushtit 2019, paragrafi 60).

35. Gjykata gjithashtu ka pohuar vazhdimisht se nuk është roli i saj të rishikojë konkluzionet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale dhe se ajo nuk mund të vlerësojë vetë faktet të cilat e kanë bërë një gjykatë të rregullt të marrë një vendim e jo një tjetër. Në të kundërtën, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “shkallës së katërt”, që do të rezultonte në shpërfilljen e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj (shih, në këtë kontekst, rastin e GjEDNj-së *García Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28 dhe referencat e përdoruar aty; dhe shih, gjithashtu rastet e

Gjykatës, KI49/19, cituar më lart, paragrafi 48; dhe KI154/17 dhe KIO5/18, cituar më lart, paragrafi 61).

36. Gjykata, megjithatë, thekson se praktika gjyqësore e GjEDNj-së dhe e Gjykatës gjithashtu përcaktojnë rrethana nën të cilat duhet të bëhen përjashtime nga ky qëndrim. Siç u theksua më lart, përderisa gjykatat e rregullta kanë detyrë primare të zgjidhin problemet rreth interpretimit të ligjit të aplikueshëm, roli i Gjykatës është që të sigurohet apo të verifikojë që efektet e këtij interpretimi të jenë kompatible me Kushtetutën dhe KEDNj-në (shih rastin e GjEDNj-së, *Miragall Escolano dhe të tjerët kundër Spanjës*, Aktgjykim i 25 majit 2000, paragrafët 33-39; dhe shih, gjithashtu rastin e Gjykatës KI154/17 dhe KIO5/18, cituar më lart, paragrafi 63). Në parim, një përjashtim i tillë, ndërlidhet me raste të cilat rezultojnë të jenë dukshëm arbitrare, duke përfshirë ato në të cilat, një gjykatë ka “*aplikuar ligjin në mënyrë qartazi të gabuar*” në një rast specifik dhe i cili mund të ketë rezultuar në “*konkluzione arbitrare*” apo “*qartazi të paarsyeshme*” për parashtruesin përkatës (për një sqarim më të detajuar përkitazi me konceptin e “*aplikimit të ligjit në mënyrë qartazi të gabuar*”, shih, ndër të tjera, Udhëzuesin e GjEDNj-së për nenin 6 të KEDNj-së (aspekti civil), të 31 gushtit 2020, pjesën IV. Kriteret Procedurale; 3. Shkalla e Katërt; b. Fushëveprimi dhe Kufizimet e mbikëqyrjes së Gjykatës, paragrafët 329-333; dhe rastin e Gjykatës KI154/17 dhe KIO5/18, cituar më lart, paragrafët 60 deri në 65 dhe referencat e përdorura aty).
37. Për me tepër, Gjykata vëren se pretendimi i parashtruesit të kërkesës është adresuar nga Gjykata e Apelit, si instancë përfundimtare në këtë procedurë, duke arsyetuar: “*se nuk qëndron pretendimi ankimor i debitorit të dytë se aktvendimi i atakuar është marrë me shkelje të dispozitave të procedurës përmbartimore, për faktin se në rastin konkret përmbartuesi privat e ka lejuar përmbartimin duke u bazuar në Marrëveshjen mbi Kredinë Personale me Nr.120233721, Marrëveshjen mbi Pengun Nr.120233721, e cila është e regjistruar në regjistrin përkatës, dhe e njëjta paraqet dokument përmbartues në kuptim të dispozitës së nenit 5 paragrafi 2 të Ligjit nr.05/L-118, për Ndryshimin dhe Plotësimin e LPP-së, shprehimisht përcaktohet se: "kontrata për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut", e që në rastin konkret janë përmbushur të gjitha kushtet e parapara ligjore për lejimin e përmbartimit*”.
38. Duke marrë parasysh pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës dhe shkresat e lëndës, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur të dëshmojë se efektet e interpretimit dhe të zbatimit të së drejtës materiale dhe procedurale janë jo-kompatible me të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe KEDNj. Për me tepër nga arsyetimet e vendimeve vërehet qartë se në rrethanat e rasti konkret nuk kemi të bëjmë as me “*aplikim të ligjit në mënyrë qartazi të gabuar*” dhe as me “*konkluzione arbitrare*” apo “*qartazi të paarsyeshme*”.
39. Andaj, nga sa më lartë, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale dhe procedurale bien në kategorinë e parë (i) të pretendimeve të “*shkallës së katërt*” dhe si të tilla, reflektojnë pretendime në nivel ligjshmërie dhe nuk janë argumentuar në nivel kushtetutshmërie, andaj, si të tilla, duhet të shpallen qartazi të pabazuara, në baza kushtetuese, në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

b) Përkitazi me parashkrimin e të drejtës së kreditorit për të kërkuar përmbushjen e detyrimit (borxhit)

40. Gjykata fillimisht rikujton se pretendimet që kanë të bëjnë me parashkrimin e të drejtës, ngrenë çështje kushtetuese, gjegjësisht të sigurisë juridike të cilat kanë të bëjnë me afatshmërinë apo kufizimin e të drejtës për të kërkuar mbrojtje gjyqësore në gjykatë.
41. Gjykata në lidhje me këtë pretendim konkret rikujton se parashtruesi i kërkesës vetëm përmend çështjen e parashkrimit, megjithatë ai nuk shtjellon tutje se në bazë të cilit ligj apo dispozite të veçantë ligjore është parashkruar e drejta e kreditorit për të kërkuar përmbushjen e detyrimit (borxhit) dhe si ka ardhur deri të shkelja e kësaj të drejte. Gjykata ka theksuar vazhdimisht, se kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës dhe të KEDNj-së, parashtruesit i kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara mirë dhe argumente bindëse (shih, në këtë kontekst, rastin KIO4/21, me parashtruese *Nexhmije Makolli*, Aktvendim për papranueshmëri, i 11 majit 2021, paragrafët 38- 39, dhe rastet e cituara aty).
42. Për me tepër përkitazi me parashkrimin, Gjykata vëren se Gjykata Themelore në Gjakovë, në aktgjykimin e saj të 30 dhjetorit 2019, kishte arsyetuar se: *“Nuk qendrën as pretendimi i debitorit se kërkesa për kërkimin e borxhit është parashkruar, ngase me dispozitat e Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve janë përcaktuar kushtet e rrjedhjes së parashkrimit, e në rastin konkret nuk janë përmbushur kushtet për parashkrimin e kërkesës së kreditorit, e aq me tepër kur në këtë rast kërkesa e kreditorit është siguruar me të drejtën e pengut, e cila mund të ushtrohet edhe atëherë kur kërkesa e siguruar është parashkruar ashtu që siç përcaktojnë dispozitat e Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore”*.
43. Gjykata në këtë rast vëren se parashtruesi i kërkesës thjeshtë nuk është pajtuar me rezultatin e procedurës dhe të gjykimit të çështjes së tij pranë gjykatave të rregullta sa i përket çështjes së parashkrimit. Megjithatë, pakënaqësia e tij nuk mund vetvetiu të ngrejë një pretendim të argumentueshëm për shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë (shih rastin e GJEDNj-së *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005).
44. Nga arsyet e lartëcekura, Gjykata konstaton se pretendimi i parashtruesit të kërkesës në lidhje me parashkrimin e të drejtës së kreditorit për të kërkuar përmbushjen e detyrimit, i përket kategorisë (iii) të pretendimeve *“të pambështetura ose të paarsyetuara”*, andaj, si të tillë, të njëjtin e shpallë qartazi të pabazuar në baza kushtetuese dhe rrjedhimisht të papranueshëm, në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

ii. Sa i përket pretendimeve për shkelje të së drejtës për “mjete efektive juridike”

45. Në lidhje me këto pretendime, Gjykata rikujton se sipas jurisprudencës së GJEDNj-së, dhe të vetë Gjykatës, ajo e shpall një kërkesë të papranueshme qartazi të pabazuar, në baza kushtetuese, në pajtim me kriterin (iii) të

pretendimeve “të pambështetura apo të paarsyetuara” kur plotësohet njëri nga dy kushtet, në vijim:

- a) kur parashtruesi i kërkesës thjesht citon një ose disa dispozita të Konventës apo të Kushtetutës, pa shpjeguar mënyrën se si ato janë shkelur, përveç nëse kjo është qartazi e dukshme në bazë të fakteve dhe rrethanave të rastit (shih, në këtë drejtim, rastin e GjEDNj-së *Trofimchuk kundër Ukrainës (vendim)* nr. 4241/03 i 31 majit 2005; shih gjithashtu *Baillard kundër Francës (vendim)* nr. 6032/04 i 25 shtatorit 2008);
 - b) kur parashtruesi i kërkesës nuk paraqet ose refuzon të paraqesë prova materiale, me të cilat do t'i mbështeste pretendimet e tij (kjo posaçërisht vlen për vendimet e gjykatave ose të autoriteteve të tjera të brendshme), përveç rasteve kur ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që janë jashtë kontrollit të tij dhe të cilat e pengojnë atë ta bëjë këtë (për shembull, kur administrata e burgut refuzon t'ia paraqesë Gjykatës dokumentet nga dosja e një të burgosuri për të cilin bëhet fjalë) ose nëse Gjykata vet nuk vendos ndryshe (shih rastin KI166/20, parashtrues, *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 janarit 2021, paragrafi 43).
46. Në vlerësimin e këtyre pretendimeve Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës vetëm përmend nenin 32 të Kushtetues dhe nenin 13 të KEDNj-së megjithatë edhe në lidhje me këto dispozita konkrete ai nuk shpjegon tutje se si dhe pse ka ardhur deri të shkelja e të drejtës për mjete efektive juridike. Gjykata përsërit se ajo ka theksuar vazhdimisht se vetëm referimi dhe përmendja e neneve të Kushtetutës dhe të KEDNj-së nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim të argumentuar për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNj, parashtruesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës: KI175/20, me parashtrues: *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendim për papranueshmëri, i 22 prillit 2021, paragrafi 81; KI166/20 cituar më lart, paragrafi 52; KIO4/21, me parashtruese *Nexhmije Makolli*, Aktvendim për papranueshmëri, i 11 majit 2021, paragrafët 38-39).
47. Nga kjo arsye, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me parashkrimin e së drejtës dhe për mjete efektive juridike, i përkasin kategorisë së tretë (iii) të pretendimeve “të pambështetura ose të paarsyetuara”, andaj, si të tilla, duhet të shpallen qartazi të pabazuar, në baza kushtetuese, në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

Përfundim

48. Si përmbledhje, Gjykata, duke i marrë parasysh të gjitha shtjellimet dhe konstatimet e mësipërme, konkludon se:
- i. pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të së drejtës për “gjykim të drejtë” në lidhje me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale dhe procedurale i përkasin kategorisë së parë (i) të pretendimeve të gjykatës së “shkallës së katërt” dhe si të tilla, reflektojnë pretendime në nivel “ligjshmërie”, sepse nuk janë ngritur dhe argumentuar në nivel

"kushtetutshmërie", andaj, si të tilla, duhet të shpallen qartazi të pabazuara, në baza kushtetuese, në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës;

- ii. pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me parashkrimin e të drejtës së kreditorit për të kërkuar përmbushjen e detyrimit dhe pretendimi për shkelje të së drejtës për mjete efektive juridike, i përkasin kategorisë së tretë (iii) të pretendimeve "të pambështetura ose të paarsyetuara", andaj, si të tilla, duhet të shpallen qartazi të pabazuara, në baza kushtetuese, në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

49. Rrjedhimisht, kërkesa në tërësinë e saj, duhet të deklarohet e papranueshme, në baza kushtetuese, në pajtim me rregullin 39 (1) (b) dhe (2) të Rregullores së punës.

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe me rregullat 39 (2) dhe 59 (1) të Rregullores së punës, në seancën e saj të mbajtur, më 10 nëntor 2021, njëzëri

VENDOS


- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Safet Hoxha



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Gresa Caka-Nimani